



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan me 01. 06. 2018

Relacion

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA-se 2019-2021

1. Ngritja e grupeve të punës

Vendim i Kryetarit të Bashkisë Elbasan nr.860, date 09.10.2015 “Për ngritjen e Grupit për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI), në kuadër të hartimit të PBA, për Bashkinë Elbasan.

2. Miratimi i Raportit të Vleresimeve dhe Parashikimeve Aftmesme.PBA-se.

Këshilli Bashkiak, miratoi Raportin e Vleresimeve dhe Parashikimeve Aftmesme 2019-2021, me Vendimin nr. 16, date 25.01.2018.

3. Miratimi i Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve Aftmesme 2019-2021.

Këshilli Bashkiak, miratoi Tavanet Përgatitore të Shpenzimeve Aftmesme 2019-2021, me Vendimin nr. 27, date 20.02.2018.

4. Funksionimi i grupeve të punës.

Drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve paraqiten kërkesat buxhetore tek nepunesi autorizues deri me date 28 prill 2018.

GSBI në mbledhjen e dates 30.04.2018, miratoi raportet e përgatitura nga Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP).

II. Analize e tendencës se te ardhurave

1. Te ardhurat gjithsej (dy vite me pare, viti aktual dhe tre vitet e ardhshme).

Ne mije leke

2016	2017	2018	2019	2020	2021
3,789,915	4,053,805	4,614,875	4,357,594	4,381,358	4,414,820

2. Te ardhurat nga burimet e veta (dy vite me pare, viti aktual dhe tre vitet e ardhshme).

Ne mije leke

2016	2017	2018	2019	2020	2020
568,033	646,460	1,174,277	1,174,377	1,151,116	1,152,001

3. Te ardhura nga buxheti qendror (dy vite me pare, viti aktual dhe tre vitet e ardhshme).

Ne mije leke

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Transf. pakushtez	510,459	576,731	636,618	650,772	697,797	765,374
Transf.kushtezuar	2,069,365	2,241,609	2,099,400	2,099,400	2,099,400	2,099,400
Transf.specifike	347,796	377,910	398,045	398,045	398,045	398,045

III. Tendencat e politikave te shpenzimeve

1. Analiza e tendencës se shpenzimeve sipas funksioneve (dy vite me pare, viti aktual dhe tre vitet e ardhshme).

Ne mije leke

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shpenzime total	3,602,457	3,772,928	4,614,875	4,357,594	4,381,358	4,416,820

2. Analiza e shpenzimeve për pagat (dy vite me pare, viti aktual dhe tre vitet e ardhshme)

Ne mije leke

Emërtimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shpenzime paga	655,181	772,344	832,212	832,212	832,212	832,212
Shpenzime sigurime	108,392	133,801	139,953	139,953	139,953	139,953
TOTAL	763,573	906,145	972,165	972,165	972,165	972,165
:						

- Përqindja që zënë këto shpenzime ndaj totalit të shpenzimeve (dy vite me parë, vitin aktual dhe tre vitet e ardhshme)

Ne përqindje

2016	2017	2018	2019	2020	2021
21,2%	24%	21 %	22.3 %	22.2%	22 %

3. Analiza e shpenzimeve korente (dy vite me parë, viti aktual dhe tre vitet e ardhshme)

Ne mijë leke

Emërtimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shpenzime total	1,973,724	2,099,570	2,574,210	2,354,418	2,354,418	2,372,588

- Përqindja që zënë këto shpenzime ndaj totalit të shpenzimeve (dy vite me parë, vitin aktual dhe tre vitet e ardhshme)

Ne përqindje

2016	2017	2018	2019	2020	2021
54.8%	55.6 %	55.8%	54 %	53.7%	53.7 %

4. Analiza e shpenzimeve kapitale (dy vite me parë, viti aktual dhe tre vitet e ardhshme)

Ne mijë leke

Emërtimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shpenzime total	865,160	767,213	1,068,500	1,031,011	1,054,775	1,070,062

- Përqindja që zënë këto shpenzime ndaj totalit të shpenzimeve (dy vite me parë, vitin aktual dhe tre vitet e ardhshme)

Ne përqindje

2016	2017	2018	2019	2020	2021
24%	20.3%	23.1 %	23.7%	24 %	24.2%

IV. Detyrimet e prapambetura.

Detyrimet e prapambetura të Bashkisë janë parashikuar të likujdohen gjatë vitit 2018, pra janë pjesë e buxhetit të vitit 2018, dhe do të likujdohen me të ardhurat e trashëguara. Këto detyrime erdhën si pasojë e limitit të vendosur në Degen e Thesarit gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2017. Në buxhetin e vitit 2018 trashëgohen 280,877

mije leke nga viti 2017 dhe jane planifikuar ne buxhetin e vitit 2018 per shkyerjen e detyrimeve te prapambetura nga vitit 2017.

V. Prioritetet e investimeve

Investimet janë përqendruar kryesisht ne përmirësimin e infrastrukturës.

- Fushat prioritare për dy nga funksionet me te mëdha
 - Ne programin e Transportit ne funksionin e infrastruktures rrugore si fushë prioritare është zgjerimi i rrugeve ne qytet nepermjet dhe ndërtimi i te gjitha rrugeve ekzistuese.
 - Ne programin e Sherbimeve Kreative dhe Sportive si fushë prioritare është ndertimi i siperfaqeve te gjelberuara dhe ambjenteve shlodhese si dhe permiresimi i atyre ekzistuese, duke ndikuar ndjeshem ne cilesine e ajrit ne qytet.
 - Ne programet e Arsimit parashikohet si prioritet parashikohet rikonstruksioni i objekteve arsimore, duke synuar ndetimin e sistemeve te ngrohjes ne kopeshte dhe shkolla.

VI. Konkluzione

Ne hartimin Programit Buxhetor Afatmesem 2019-2021, jane respektuar procedurat standarde ne zbatim te udhezimit te Ministrise se Financave nr.23, date 22.11.2016 “Per procedurat standarde te pergatitjes se Programit Buxhetor Afatmesem” dhe udhezimit nr.6/1, date 28.02.2018 “Per pergatitjen e buxhetit vendor”. Ne planifikim e te ardhurave si baze ka sherbyer planifikimi i vitit 2018, duke ruajtur nivelin ekzistues (te miratuar) te taksave dhe tarifave per vitet 2019-2021.

Janë respektuar procedurat e hartimit te buxhetit madje ne ketë kuadër janë organizuar disa seanca dëgjimi me komunitetin te cilat kanë ndihmuar ne zgjedhjen e prioriteteve.

Persa i takon shpenzimeve per personelin, per periudhen 2019-2021 nuk eshte planifikuar rritje, pra eshte parashikuar te ruhet i njeji nivel i pagave.

Ne shpenzimet per administaten, jane perfshire projektet per barazine gjinore.

Ne kete kuader, per periudhen 2019-2021, jane planifikuar takime ndergjegjesuese me pjesemarrjen e grave dhe vajzave ;

- Qellimi strategjik 1: Reduktimi i dhunes me baze gjinore dhe i dhunes
- ne familje.
- Objektivi specifik 1.1: Ndergjegjesimi i shoqerise per te mos pranuar dhe toleruar ushtrimin e dhunes me baze gjinore dhe dhunes ne familje.

- Objektivi specifik 1.2: Mbeshtetja e viktimave/te mbijetuarave me sherbime me qellim integrimin ne shoqeri.

Ne shpenzimet per investime ne vitin aktual dhe ne vitet 2019-2020 eshte perfshire huaja e miratuar per shpronësime dhe investime ne infrastrukturen rrugore.